



TERMAT E REFERENCES

Lloji i Shërbimit	Ekspertizë për mbështetjen e grupit punues në hartimin e Projekt Udhëzimit Administrativ për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehimin rezidencial.
Vendi	Kosovë
Kohëzgjatja	10 ditë pune
Data e pritshme e fillimit	Mars 2024
I raporton	SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë

1. Hyrje

Këto terma të referencës shërbejnë si kërkesë për propozime nga Kompanitë/ ekspertët individual që janë të interesuar të lehtësojnë dhe mbështesin grupin punues në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, në hartimin e Projekt Udhëzimit Administrativ për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehimin rezidencial.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

SOS Fshatrat e Fëmijëve Internacional është organizata ombrellë e federatës botërore e 118 shoqatave kombëtare të SOS Fshatrave të Fëmijëve, që veprojnë me programet e tyre në shumë vende të botës. Ne punojmë bashkërisht me një vizion të vetëm: çdo fëmijë i përket një familje dhe rritet me dashuri, respekt dhe i sigurt. Ne ofrojmë përkujdesje afatgjatë familjare, në mënyrë unike, për fëmijët dhe të rinjtë që e kanë humbur kujdesin prindëror, me familjet dhe komunitetet e cenueshme për t'u ndihmuar që të fuqizohen dhe ta parandalojnë braktisjen e fëmijëve.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është organizatë joqeveritare për zhvillim social, e cila është aktive në fushën e të drejtave të fëmijëve duke i mbështetur nevojat dhe shqetësimet e tyre që nga viti 1999. Ne ndërtojmë familje për fëmijë pa përkujdesje prindërore, ne u ndihmojmë atyre që ta formësojnë të ardhmen e tyre dhe marrim pjesë në zhvillimin e komuniteteve të tyre.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë punon në partneritet me institucionet përgjegjëse, organet shtetërore, akterët kryesorë, organizatat kryesore dhe ofruesit e shërbimeve në fushën e mbrojtjes sociale të fëmijëve në nevojë, dhe u krijon mundësi të rinjëve që të përfshihen me kontributin dhe ndikimin e tyre në formësimin dhe hartimin e politikave dhe në zhvillimin e shërbimeve dhe programeve.



1.1 Konteksti i programit

Në kuadër të planeve dhe aktiviteteve të përbashkëta mes Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht Departamenti i Shërbimeve Sociale dhe Mbrojtjes së Fëmijëve dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, po kërkojmë një Kompani/ Ekspert tematik individual për të lehtësuar dhe mbështetur punën e grupit punues në hartimin e Projekt Udhëzimit Administrativ për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehimin rezidencial.

1.2 Kohëzgjatja e vlerësimit

Data e synuar e fillimit të angazhimit është Mars 2024, ndërsa angazhimi do të përfundojë në Qershor 2024, me gjithsej 10 ditë angazhimi.

2. Qëllimi i shërbimit

2.1 Qëllimi i këtij angazhimi është mbështetja e grupit punues në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, për hartimin e Projekt Udhëzimit Administrativ për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehimin rezidencial. Ky udhëzues hartohet me qëllim të organizimit për sa i përket përcaktimit dhe detyrave e përgjegjësive të panelit për strehim rezidencial.

2.2. Rezultatet e pritshme

- Draftimin e Udhëzuesit për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehimin rezidencial;
- Fasilitimin e punëtorive të grupit punues gjatë periudhës së hartimit të Udhëzuesit administrativ;
- Të prezantojë dhe inkorporojë komente/ propozime pas punëtorisë me grupin punues dhe akterët e përfshirë në grup punues për hartimin e Udhëzuesit;
- Hulumtimin e përvojave nga vendet tjera në hartim të një Udhëzuesi të tillë lidhur me organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehimin rezidencial;
- Dorëzimi i draftit përfundimtar të Udhëzuesit për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehimin rezidencial;

Plani i punës së bashku me metodologjinë e propozuar të cilat i ofron kompania/ eksperti duhet të përshkruajnë në detaje planin e punës dhe metodologjinë (metodat dhe mjetet e punës) duke përfshirë edhe objektivat kryesore, hapat dhe procedurat se si do të realizohet angazhimi, përpilimi i të dhënave, afati kohor, etj.

3. Shkathtësitë e kërkuara (përvoja dhe kualifikimet) nga kompania/ eksperti

- Kompetencë/përvojë të dëshmuar (të dhënat e përvojës paraprake) në angazhime të ngjashme;



- Nivel universitar shkollimi në shkenca sociale, juridik, menaxhim projektsh ose ndonjë fushë te ngjashme.
- Të ketë përvojë së paku tri vjet përvojë në fushën e hartimit të akteve ligjore juridike ose punës në fushën e mbrojtjes sociale, punës ose dialogut social;
- Të ketë përvojë të dëshmuar në përpilim dhe hartim të dokumenteve në fushën përkatëse;
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme analitike dhe konceptuale;
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme në shkrim dhe komunikim;
- Duhet të ketë njohuri të mira për sistemin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve;
- Të ketë njohuri të mira për sistemin e shërbimeve sociale dhe familjare;
- Të ketë përvojë dhe punë të dëshmuar me institucione nga sektori shoqëror dhe organizata që ofrojnë shërbime sociale;
- Duhet të ketë përvojë të dëshmuar të bashkëpunimit efektiv me institucionet publike në nivelin qendror dhe lokal, ofruesit e shërbimeve publike dhe OJQ-të;
- Duhet të ketë shkathtësi të mira personale dhe ndër-personale për punë në ekip;
- Duhet të garantojë dorëzimin me kohë të rezultateve dhe detyrave të pritshme;
- Duhet të jetë i njoftuar me standardet etike lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët dhe do t'i kërkohet që të nënshkruajë dhe t'i përmbahet Politikave për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Njohuri dhe përvoja të punës/ bashkëpunimit të mëhershëm me SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është përparësi.

4. Periudha kohore

Angazhimi do të realizohet nga Mars deri në Qershor 2024.

5. Produktet që duhet të dorëzohen në fund të angazhimit:

- Dorëzimi i draftit përfundimtar të Projekt Udhëzimit Administrativ për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehimin rezidencial;

6. Aneksi – Politikat për mbrojtjen e fëmijëve dhe kodi i sjelljes i SOS Fshatrat e Fëmijëve

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë e ka dokumentin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve dhe kodin e sjelljes, të cilat kompania/ eksperti pritet t'i përmbahet dhe nga ta do të kërkohet ta nënshkruajnë një deklaratë të zotimit ndaj këtyre politikave. Kjo do të bëhet me rastin e nënshkrimit të kontratës, ku konsulenti do të udhëzohet lidhur me proceset e brendshme të mbrojtjes së fëmijëve dhe rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave.



7. Udhëzime për ofertuesit (procesi i dorëzimit të ofertave)

I ftojme ofertuesit që t'i dorëzojnë propozimet e tyre për mbështetjen e hartimit të Projekt Udhëzimit Administrativ për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehimin rezidencial në formatin PDF dhe t'i dërgojnë në mënyrë elektronike në email adresën: procurement1@soskosova.org

Ftesa është e hapur për të gjithë kompanitë/ ekspertët e pavarur që mund t'i ofrojnë shërbimet e kërkuara. Propozimi dhe të gjitha dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe.

Dokumentet që duhet dorëzuar:

Për kompani:

1. Certifikatën e Biznesit/ NUI
2. Oferta e nënshkruar dhe vulosur
3. Oferte financiare ne euro pa tvsh
4. CV e ekspertit që do të angazhohet
5. Propozimi teknik dhe metodologjia për kryerjen e shërbimit të kërkuar
6. Tri letër referenca

Për ekspert individual:

1. CV e ekspertit
2. Kopje e letër-njoftimit
3. Letër interesi
4. Propozimi teknik dhe metodologjia për kryerjen e shërbimit të kërkuar
5. Tri letër referenca
6. Oferta financiare- çmimi në euro duhet të konsiderohet pagesë BRUTO

Oferta duhet të jetë e vlefshme për dy javë

Ofertuesi i përzgjedhur, para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë: Vërtetim që nuk është nën hetime

8. Kohëzgjatja e kontratës dhe kushtet e pagesës

- Pagesa do të bëhet vetëm pasi SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë ta pranojë punën e realizuar sipas produkteve të përshkruara më lartë. Pagesa do të bëhet nëpërmjet transferit bankar në llogarinë bankare të kompanisë. Për ekspert individual duke ndalur tatimin në të ardhura personale dhe kontributin pensional, sipas ligjit në fuqi dhe jo më vonë se 30 ditë pas pranimit të punës së realizuar;
- Pagesa do të bëhet me këste, si në vijim:
 - 50% me rastin e përfundimit të draftit të parë të Projekt Udhëzimit Administrativ për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehimin rezidencial;



- 50% me rastin e përfundimit të draftit final të Projekt Udhëzimit Administrativ për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehimin rezidencial;

Kriteret e përzgjedhjes:

Kriteret	Maksimumi i pikëve
<ul style="list-style-type: none">• Përvoja e ekspertit në procese të këtilla angazhimi. Vlerësimi bëhet në bazë të kualifikimeve dhe përvojës.	30
<ul style="list-style-type: none">• Metodologjia e propozuar për realizimin e shërbimit është e përshtatshme, ndërsa plani i punës është real dhe e përmbush qëllimin.	35
<ul style="list-style-type: none">• Çmimi i ofertës financiare	35
Totali	100

Afati për dorëzim:

Aplikacioni duhet të dërgohet më së voni me datë: 19.03.2024 deri në mesnatë. Aplikacionet që dërgohen pas këtij afati nuk do të merren parasysh.